



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:200577
Datë: 31.10.2024
Numri i dokumentit: 06379917

C.nr.4800/24

Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtarja Edona Zuzaki, me bashkëpunëtorin profesional Milot Mehmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.SH nga Gjilani, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson L.B, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit në punë dhe inflacion në pagë, me vlerë të kontestit 1,098.40 euro, jashtë seancës, me datë 30.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.SH nga Gjilani, dhe DETYROHET e paditura komuna e Gjilanit që në emër të kompensimit për ushqimin ditor për periudhën kohore 01.09.2021-21.11.2022, për 100 ditë pune, duke llogaritur nga 2 euro në ditë, t'ia paguaj paditësit shumën prej 200.00 euro, dhe në emër të inflacionit vjetor për periudhën kohore 01.07.2021 – 31.10.2022, (duke marrë për bazë pagën e paditëses prej 421.00 euro), t'ia paguaj shumën prej 574.24 euro, apo shumën e përgjithshme prej 774.24 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % duke llogaritur nga data 11.07.2024, si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. Refuzohet e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, e kërkuar më tepër se shuma e aprovuar si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi në shumë prej 92.00 euro, për periudhën 24 Janar 2021 – 21 Qershor 2021, në emër të kompensimit për ushqimin ditor, dhe shuma prej 232.16 euro, për periudhën Janar 2019 – Qershor 2021, në emër të kompensimit për inflacion.

III. DETYROHET e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës t'ia paguaj paditëses shumën prej 134.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarit të tij më datë 11.07.2024, ka paraqitur padi, në këtë gjykatë kundër të paditurës për kompensimin e ushqimit dhe inflacionit, me vlerë të kontestit 1,098.40 euro.

Në padi, ka theksuar se e njëjta është e punësuar tek e paditura, në Shkollën e Mesme e Lartë Profesionale e Mjkësisë “Dr.Asllan Elezi” (në vijim: SHMLPM) “Dr.Asllan Elezi” në Gjilan, . Bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë (në vijim: KKAK) të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021 ka shtuar se paditëses i takon kompensimi për shpenzimet e ushqimit për periudhën kohore 25.01.2021-21.11.2022, për 146 ditë pune dhe në emër të inflacionit për periudhën kohore Janar 2019 – Tetor 2022. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditëses dhe të detyrojë të paditurën t’ia kompensojë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe në emër të inflacionit në shumë totale prej 1,098.40 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 104.00 euro për përpilim të padisë dhe 30.00 euro për taksë gjyqësore.

E paditura me shkresën e datës 04.12.2023 ka parashtruar përgjigje në padi lidhur me të gjitha çështjet kontestuese sa i përket kërkesave: shpërblim jubilar, ushqim, udhëtim, kualifikim dhe inflacion, të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2017 dhe 2021 si dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/33 të datës 29.08.2008. Meqë objekt kontesti i kësaj çështje juridike është kompensimi për shkak të shpenzimeve të ushqimit, kualifikimit dhe inflacionit, gjykata vlerëson se kjo shkresë shërben si përgjigje në padi në lëndën konkrete. Kundërshtimet e të paditurës theksojnë se sa i përket kompensimit të shpenzimeve për udhëtim, të njëjtat nuk duhet të njihen nëse nuk argumentohen me prova përkatëse (certifikatë e vendbanimit, pagesë mujore në kompani transportuese, çmimi i biletës...). Sa i përket diferencës në pagë për shkak të kualifikimit, vendimi i qeverisë në fjalë është zbatuar sipas detyrës zyrtare posa ka hyrë në fuqi (me rastin e rritjes së pagave), andaj vendimi i njëjtë nuk mund të zbatohet dy herë. Sa i përket inflacionit, kjo e drejtë nuk i takon të punësuarve në sektorin e arsimit, pasi nuk mund të godet vetëm një sektor të punësimit, por të gjithë sektorët e aparatit shtetëror. Për të gjitha kërkesat, gjykatës i ka propozuar të vlerësojë parashkrimin e tyre, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës dhe kërkesave periodike nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë” dhe 399.1 që përcakton se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin merititor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësja është e punësuar te e paditura fakt i vërtetuar nga kontrata e punës në kohë të pa caktuar së paditëses me të paditurën, nr.prot.254 e dt.01.09.2017, dhe për periudhën kohore nga dt. 25.01.2021-21.11.2022, ka gjithsej 146 ditë të pranisë në punë, kurse për periudhën 1 shtator 2021 -21 nëntor 2022, ka gjithësej 100 ditë të pranisë në punë (fakt i vërtetuar nga vërtetimi me nr.prot.04/261, i dt.20.10.2023 i lëshuar nga SHMLPM “Dr.Asllan Elezi” në Gjilan), dhe se pagën bazë e ka pasur në lartësi prej 469.90 euro, (fakt i vërtetuar edhe nga kontrata e punës).

Sa i përket shkallës së përqindjes të inflacionit, gjykata nga Enti i Statistikave të Republikës së Kosovës ka gjetur se kjo përqindje për vitin 2021 është prej 3.4 % dhe për vitin 2022 është prej 11.6 %.

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, prova në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritorë, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Nga të njëjtat gjykata provoi se përqindja e shkallës së inflacionit sipas entit të statistikave për vitin për vitin 2021 është prej 3.4 % dhe për vitin 2022 është prej 11.6 %.

Gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I dhe jo themelësia e refuzuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në në Kontratat Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021.

Në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, në nenin 3, paragrafi 2 është përcaktuar se “I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”; neni 35, paragrafi 7 se: “Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është 2 euro (dy euro) për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit të kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”; neni 35, paragrafi 10 përcakton se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”,

Dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit për vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022, zbatimi i të cilave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Lartësinë e kërkesëpadisë sa i përket shpenzimeve të ushqimit, gjykata e vërtetoi nga fakti se për shpenzimet e ushqimit nga 2 euro në ditë, për 100 ditë në total, arrijnë vlerën prej 200 euro.

Nga të theksuarat më sipër, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ia aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë paditëses për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe inflacionit.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi vlerëson se periudha kohore e kërkuar për këto kompensim është pjesërisht e përfshirë në parashkrim. Meqë e paditura është thirrur në parashkrim gjykata bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, kërkesa e paditëses llogaritet 3 vite mbrapa nga data e parashtrimit të kërkesës. Meqë padia është ushtruar më datë 11.07.2024, në bazë të kësaj dispozite ligjore, kërkesa duhet llogaritur nga muaji Korrik 2021, ndërsa paditësja kompensimin e ka kërkuar nga data 25.01.2021 për ushqim, kurse për kompensimin për inflacion e ka kërkuar 01.01.2019. Në rastin konkret periudha Janar 2019 – Korrik 2021, është e përfshirë në parashkrim.

Po ashtu, nga të theksuarat më sipër, gjykata vendosi si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi gjeti se paditëses nuk i është kompensuar shkalla e përqindjes së inflacionit për vitin 2021 nga Korrik 2021 deri në tetor 2022, ndërsa ky kompensim arrin lartësinë prej 574.24 euro sipas shkallës së llogaritur nga enti i statistikave (neni 35.10).

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata ka parasysh se e paditësja sipas kontrates së punes pagen e ka pasur 469.90 euro, ndërsa paditësja e ka kërkuar kompensimin në emer të inflacionit për pagen 421.00 euro, por çdo vendosje ndryshe do të përbënte tejkalim të kërkesëpadisë. Po ashtu, sa i përket inflacionit të njëjtën e ka kërkuar deri më datë 31.10.2022, përderisa kontrata zbatohet deri më datë 21.11.2022, mirëpo çdo vendosje ndryshe do të përbënte tejkalim të kërkesëpadisë.

Lidhur me pretendimin e të paditurës se inflacioni nuk mund të kërkohe vetëm në një sektor të punës, gjykata vlerëson se me kontratë kolektive është përcaktuar se inflacioni ka ndikim në pagën e mësimdhënësve – të punësuarve si në nenin 3.2 të KKAK-së, prandaj edhe këtë pretendim e gjeti të pabazuar.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditëses në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës, për përpilimin e padisë shumë 104.00 euro dhe taksën gjyqësore në shumë prej 30.00 euro.

Nga të lartcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.4800/24, datë 30.10.2024

Gjyqtarja,
Edona Zuzaki

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj gjykate.